



# Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, e mbajtur më 26.08.2011, në sallën e KK Rahovec, me fillim në ora 10:00. Të pranishëm: këshilltarët e KK-së, kryetari i Komunës z.Smajl Latif, nënkryetari z.Hazër Tara, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e KFOR-it-Lmt, MAPL, OSBE, KDI dhe mediat.

Mbledhjen e ka kryesuar Kujtim Popaj, i cili në fillim ka përshëndetur të pranishmit dhe për mbledhjen e sotme ka propozuar këtë

## REND DITE

1. Shqyrtimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
2. Shqyrtimi i Raportit të kryetarit të Komunës për situatën ekonomike financiare të Komunës dhe zbatimin e planeve investuese për periudhën gjashtëmujore janar-qershor 2011,
3. Informatë nga Drejtoria e Arsimit mbi përgatitjet për fillimin e vitit tëri shkollor 2011/2012,
4. Shqyrtimi i kërkesës së Fadil dhe Milaim Musli Paçarizi nga Rahoveci për dhënie në shfrytëzim të një pjese të ngastrës ndërtimore 1335/4 në pronësinë shtetërore,
5. Shqyrtimi i kërkesës së Adem Hasaj nga Rahoveci për ndarje në shfrytëzim të ngastrës kadastrale 2240/43 në pronësinë shtetërore dhe
6. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet.

**Kryesuesi** – ju njoftoj se sot Komuna e Rahovecit ka aktivitete mjaft të ngjeshura pasi që pritet të vijë një grup i deputetëve të Parlamentit të Kosovës si dhe komandanti i KFOR-it dhe nëse ka nevojë dikush prej Kuvendit të merr pjesë në ato takime dhe do të mund të ndryshojmë agjendën e seancës.

**Feim Fetoshi** – siç e dini ka disa ditë që ka rifilluar rigjykimi i Ramush Haradinaj, Lah Ibrahimaj dhe Idriz Balaj dhe të gjithë ne e dimë që ish kryeministri z.Ramush Haradinaj ish komandant i Zonës operative “Dukagjini”, gjykohej pa të drejtë. Ai doli fitues në vitin 2008 dhe ne besojmë që do të dal përsëri fitues. Në mbështetje të tij është dalë një deklaratë mbështetëse, ku shumë kuvende komunale kanë miratuar një deklaratë, të cilën shumicës së këshilltarëve ju kam dorëzuar si formë drafti, andaj ju lus që të miratojmë këtë deklaratë e cila do të procedohet më tutje.

Po ashtu kam një informatë siç jeni të informuar por edhe në aspektin zyrtar ju informoj që AAK – Dega në Rahovec që nga 11 korriku i këtij viti nuk merr asnjë përgjegjësi në aspektin politik për qeverisjen komunale të z.Latifi dhe stafit të tij. Arsyet po ashtu janë të njohura, i kemi vë në dijeni dhe i kemi theksuar qartë. Ne mendojmë që për një qeverisje të mirë, parimore dhe demokratike çdo qeveri ka nevojë për mbështetje politike. Fakti që z.Latifi nuk ka pasur dhe nuk ka mbështetje politike në Kuvendin komunal Dega e AAK-së është e detyruar për fat të keq është detyruar që të merr një hap të tillë dhe që nga 11 korriku ne nuk mbajmë asnjë përgjegjësi politike për qeverisjen Latifi. Po ashtu pyetjes së juaj eventuale për 3 kolegë tanë të cilët janë pjesë e qeverisjes së z.Latifi, ju informojmë se këta 3 kolegë vazhdojnë të jenë kolegë të AAK-së, të cilët janë edhe në struktura, por që nga kjo ditë nuk gëzojnë mbështetje politike të AAK-së në këtë qeveri dhe që nga ajo ditë janë njerëz që janë punëtorë të qeverisë së z.Latifi për të cilët edhe nuk mbajmë përgjegjësi, por natyrisht nuk kemi kërkuar tërheqjen e tyre sepse edhe ashtu z.Latifi nuk ka qenë i interesuar asnjëherë të ketë mbështetjen politike nga ky Kuvend komunal. Ne inkurajojmë z.Latifi që të pushoj të qeverisi me një Qeveri eksperimentale dhe të filloj të mendoj dhe të krijoj një Qeveri me mbështetje politike, ashtu siç qeveriset në tërë botën.

**Xhihad Vuçitërna** - edhe pse ka një vit e më shumë që kemi pritur që të dalim në sallën e re po shoh që ulëset veç janë prishur para se të përfundojmë mbledhjen e parë. Kjo është një vërejtje për organet e Komunës të cilët të cilët kanë pasur përgjegjësi të rregullojnë këtë sallë dhe operatori duhet që edhe njëherë të kryej punën si duhet. Gjithashtu e përkrahi deklaratën z.Ramuh Haradinaj për rigjykimin e tij.

**Kryesuesi** – t’ju njoftoj se ende nuk janë përfunduar të gjitha punimet sa i përket sallës kështu që pritet që pas disa ditësh rregullohen edhe punët të cilat kanë mbetur pa u rregulluar.

**Salih Hoti** – kërkoj nga Kuvendi i Komunës që seanca të bojkotohet një shenjë mos kënaqësie dhe dëshpërimi me vendimin e Qeverisë së Kosovës për procedim të Projektligjit për Hoçën e Madhe në organet e mëturshme të Qeverisë dhe të Kuvendit të Kosovës. Ne si Kuvend komunal kemi bërë një deklaratë më herët dhe kërkoj që kjo seancë e sotme të bojkotohet si rezultat i pakënaqësisë dhe lojës që është duke u bërë rreth Projektligjit të Hoçës së Madhe. Njëkohësisht kërkoj që kjo deklaratë të bëhet edhe në formë peticioni dhe t’i dërgohet të gjitha organeve të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, Presidencës dhe faktorëve ndërkombëtarë.

**Rukije Krasniqi** – nuk pajtohem me fjalimin e Feim Fetoshit lidhur me Aleancën sepse janë ato kryesisht reagime personale dhe nuk e mbështet tërësisht Aleanca nga se jam anëtare e Kryesisë së Aleancës.

**Sinan Ejupi** – ne si Grup i këshilltarëve të AKR e mbështesim deklaratën e Kuvendit komunal në mbështetje për z.Ramush Haradinaj, njëkohësisht edhe ne jemi të shqetësuar për Projektligjin e Hoçës së Madhe. Ne e dimë që nuk ka kaluar ai Projektligj, mirëpo ajo është rikthyer në rishqyrtim respektivisht riformulim, ndërsa sa i përket rendit të ditës ne pajtohemi me atë dhe të mos humbim shumë kohë por të shkojmë në shqyrtimin e elementeve kryesore të rendit të ditës.

**Esad Haxhijaha** – i kam bërë kërkesë Kuvendit të Komunës në emër të pensionuarve që mundësisht t’i paguhet 3 paga në nivel të tre muajve të ardhshëm. Meqë ende nuk ka ligj për këtë çështje në disa komuna pensionistët këtë e kanë realizuar përmes gjykatave dhe përmes Kuvendit, prandaj edhe ne kërkojmë nga Kuvendi që të na mundësoj një gjë këtillë. Ne kemi marrë një përgjigje nga Zyra e kryetarit, mirëpo ajo është jashtë ligjore sepse mbështetet në Rregulloren 2007/30 e cila është jashtë fuqisë dhe kërkoj që kjo çështje sot të vihet në rend të ditës dhe të debatohet.

**Kryesuesi** – kjo kërkesë nuk ka ardhur tek unë por nëse pajtohen këshilltarët ne mund të vendosim sot në rendin e ditës dhe ta debatojmë.

**Rasim Fazliu** – ne si Grup i këshilltarëve të PDK e mbështesim fuqishëm deklaratën për z.Ramush Haradinaj i cili qëndron në Hagë padrejtësisht. Është mirë që kemi dalë në sallë të re mirëpo duhet të bëhet sistemimi i vendeve për uljen e këshilltarëve.

**Nahit Elshani** – edhe Grupi i këshilltarëve i LDK e mbështet deklaratën e Kuvendit komunal në mbështetje të z.Haradinaj dhe besojmë fuqishëm se edhe këtë sfidë dhe këtë padrejtësi do ta kaloj z.Haradinaj dhe do të kthehet në Kosovë dhe do të filloj normal aktivitetin e tij politik. Sa i përket sallës është mirë të caktohen vendet dhe është mirë që për këtë të bisedojnë shefat e grupeve të këshilltarëve si dhe të caktohen vendet për përfaqësues të Qeverisë komunale, pastaj hapësira më e lirë për qytetarë, OJQ-të dhe të merr një formë të vërtetë të një sale të KK-së e cila do të jetë më funksionale.

**Smajl Latifi**, kryetar i Komunës – sot po e fillojmë seancën e Kuvendit komunal në sallën e re të vetëdijshëm që nuk janë përfunduar të gjitha punimet, përkundrazi ka mjaft punë që duhet të kryhen në sallë, mirëpo siç e dini janë duke u zhvilluar punimet në objektin e vjetër të Komunës, mirëpo operatori që i ka kryer punët në sallë është nga Maqedonia dhe shpresojmë se për seancën tjetër do t’i kryej punët e mbetura në këtë sallë. Shfrytëzoj rastin që edhe unë në emër të Qeverisë komunale ta përkrahi deklaratën në mbështetje të z.Ramush Haradinaj me bashkëpunëtorë dhe shpresojmë se do të zhvillohet një proces i drejtë, i arsyeshëm dhe kjo padrejtësi që po bëhet me të do të mbyllet njëherë e përgjithmonë dhe ai t’i kthehet jetës normale dhe aktiviteteve që e presin. Dëshiroj t’ju informoj se në ora 11 sot vjen Komisioni parlamentar për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mbrojtje të mjedisit dhe planifikim hapësinor, e kam ftuar urgjent sepse ekziston reziku i procedimit të Projektligjit për Hoçën e Madhe. Gjithashtu në ora 12 vjen komandanti i KFOR-it gjeneral Buhler në Rahovec dhe shpresoj që shpresoj që si në aktivitetin e Komisionit po ashtu edhe në takimin me Buhlerin do të jenë shefat e grupeve parlamentare së bashku me kryesuesin dhe me anëtarët e Qeverisë. Këto janë tema shumë të rëndësishme me të cilat ne po merremi, i trajtojmë shumë seriozisht dhe asnjë agjendë tjetër kryetarit të Komunës dhe Qeverisë komunale nuk i intereson, pavarësisht që dikush mund të ketë mendime ndryshe, neve na intereson t’i kryejmë punët tona në mënyrë sa më të mirë të mundur. Jemi të vendosur që të punojmë për interesat e qytetarëve dhe nuk na intereson çka mundet të mendoj një këshilltar.

**Kryesuesi** – edhe unë pajtohem me deklaratën në mbështetje të z.Ramush Haradinaj dhe shpresojmë që sa më shpejtë t'i kthehet punës së vet të kaluar si dhe familjes së tij dhe e vejë në votim këtë deklaratë. Pas votimit konstatoi se Deklarata për mbështetje dhe përkrahje të z.Ramush Haradinaj dhe bashkëpunëtorëve të tij njëzëri aprovohet.

**Smajl Latifi** – sa i përket kërkesës që e paraqitë z.Esad Haxhijaha, në bazë të mendimeve dhe analizave të juristëve, ne nuk kemi të drejtë të bëjmë pagesë si Qeveri komunale. Njëkohësisht kam kërkuar që nëse neve Kuvendi komunal na jep këtë mundësi ne absolutisht e shfrytëzojmë, prandaj edhe unë mendoj që mund të shqyrtohet në këtë Kuvend dhe nëse ju mendoni që ne duhet të kryejmë këtë punë, ne jemi gati të respektojmë vendimin e Kuvendit.

**Esad Haxhijaha** – nuk ka ligj për pension dhe në raste kur nuk ka ligje punohet me dispozitat e ligjeve të mëhershme pozitive. Nuk ka të bëjë me punëtorë të punësuar paslufte por për punëtorë që janë punësuar prej vitit 1965 dhe përpara është aplikuar që punëtori kur shkon në pension të merr 3 paga personale mesatare. Në përgjigjen tuaj jeni thirr në mos zgjidhjen e UNMIK-ut në Rregulloren 2000/36 dhe 2001/27 të cilat rregullore janë jashtë fuqisë. Ne si pensionistë kërkuem kemi nevojë prej Kuvendit qoftë ajo pozitive apo negative, por nëse ekziston forma dhe mundësia atëherë mund të realizoj.

**Xhemali Haxhimustafa** – lidhur me çështjen e ngritur nga z.Esad Haxhijaha, konsideroj se nuk ka nevojë Kuvendi të merret me këtë çështje sepse prej vitit 1999 me Rregulloren 2001/14 e cila rregullon çështjen e marrëdhënies së punës dhe sot Ligji mbi marrëdhënie nëpunës këto çështje janë të parapara. Sot maksimum 3 paga personale të mesatares së 3 muajve të fundit, është akti i brendshëm që i rregullon këto çështje. Çështje tjetër është që buxhetorët nuk lejojnë që të bëhen këto pagesa, mirëpo nga burimet vetanake pse jo. Në qoftë se kjo në mënyrë eksplicite nuk e përjashton askënd nga kjo e drejtë, që shkon në pension në moshën e caktuar, atëherë pse të jenë jashtë kësaj rrjedhe dhe të gjithë ata që janë në marrëdhënie pune në institucionet buxhetore dhe pse të merret vesh kur janë aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë gjë, që mundet në mënyrë shumë të qartë dhe të lehtë të zgjidhet ky problem. Çështje tjetër është nëse ka nevojë të kërkohet ndonjë sugjerim nga organet e MAPL mund të merret edhe ajo i jepet zgjidhja kësaj çështje.

**Kryesuesi** – kjo çështjet i mbetet kryetarit që të konsultohet me ligjin dhe organet tjera përkatëse dhe nëse vërtet i takojnë këto 3 paga atëherë duhet të realizohet.

**Salih Hoti** – të bëhet konsultimi me ligje dhe fakte dhe bashkërisht të marrim një qëndrim të arsyeshëm. Çështja e dytë është që parashtrova para Kuvendit dhe të vihet në aprovim.

**Kryesuesi** – është kërkesë e z.Salih Hoti për shkak se veç ka hyrë në procedurë Projektligji për H.Madhe në Parlamentin e Republikës së Kosovës, atëherë ne në shenjë të pakënaqësisë tonë në lidhje me këtë Projektligj, që sot ta bojkotojmë këtë seancë.

**Nahit Elshani** – mendoj se është kërkesë me vend dhe për shkak të aktiviteteve që janë sot me Komisionin parlamentar të Parlamentit të Kosovës lidhur me kalimin e Ligjit për Hoçën e Madhe në Qeverinë e Kosovës dhe procedimi në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe është mirë të bojkotojmë në shenjë pakënaqësie dhe proteste. Po ashtu pas takimeve që do të jenë me Komisionin parlamentar dhe me komandantin e KFOR-it, ne kryetarë të grupeve të këshilltarëve të takohemi dhe të nxjerrim një deklaratë me të cilën do të drejtohem të gjitha institucioneve vendore dhe ndërkombëtare që ne nuk do ta pranojmë këtë Ligj. Në emër të grupeve të këshilltarëve të LDK-së ne e përkrahim kërkesën e Salihut për bojkotim të kësaj seance.

**Sinan Ejupi** – edhe ne Grup parlamentar i AKR-së e përkrahim iniciativën e z.Salihut dhe sot në shenjë proteste t'i tregojmë institucioneve vendore se ne si këshilltarë komunal nuk pajtohemi me politikat të cilat momentalisht zihen në Kuvendin e Kosovës dhe jemi për bojkotimin e kësaj mbledhje në shenjë proteste për këto që deri më tani kanë ndodhë.

**Fehmi Hoxha** – ashtu siç tha edhe Kryesuesi se askush këtu nuk e përkrah atë Projektligj mirëpo duke marr përsipër që këtu kemi ne shumë çka të debatojmë edhe për shumë çështje të qytetarëve, duhet të debatojmë rreth Raportit të punës të Kryetarit, konsideroj se është e pakuptimtë që të ndërpritet seanca në këtë formë.

**Feim Fetoshi** – në emër të Grupit të këshilltarëve të AAK-së mendoj që ky Kuvend komunal në mënyrë dinjitoze ka diskutuar shpesh për këtë çështje, ka dhënë mendime unanime dhe deklaratë për këtë çështje dhe dihen mendimet dhe pozicionimet e të gjitha partive politike në Komunën e

Rahovecit, dihet mendimi dhe pozicionimi i Kuvendit të Komunës së Rahovecit , pra që këtë Ligj e konsideron si të padrejtë, të pa denjë dhe të pa dëshirueshëm. Inkurajojmë deputetët e Parlamentit të Kosovës që të kenë parasysh mendimin e kuvendarëve të Rahovecit të dhënë në disa seanca dhe ne sot duke diskutuar për çështje që janë me rëndësi të qytetarëve të Komunës së Rahovecit, ne më së shumti dalim kundër këtij ligji se sa me bojkote. Bojkotet formale konsideroj se janë të panevojshme dhe mendoj se është më tepër detyrë e ekzekutivit që mendimet dhe vendimet e Kuvendit Komunal t'i plasoj në mënyrë të denjë në qendër dhe në opinion në mënyrë që ato shihen ashtu si janë dhe të merren seriozit, pra, mendoj që seanca duhet të vazhdojë.

**Smajl Latifi** – unë e respektoj vullnetin e këshilltarëve të Kuvendit komunal, esenciale është që ne kemi unitet të plotë kundër Projektligjit për Hoçën e Madhe dhe unë ju siguroj që këto ditë kam qenë shumë i angazhuar me bashkëpunëtorët e mi. Kam takuar kryetarin e Kuvendit të Kosovës, shefat e grupeve parlamentare, kemi dërguar tërë dosjen dhe deklaratën e Kuvendit komunal me të gjitha shkresa e të cilat janë të adresuara qartë në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Ne kemi pasur takime të vazhdueshme, bashkëbisedim me njerëzit që vendosin se a duhet të procedohet më tutje ky Projektligj apo duhet të ndërpritet një orë e më parë. A do të bojkotohet apo jo seanca, ne do të jemi shumë aktiv dhe do të jemi shumë të denjë për ta mbrojtur interesin e qytetarëve të Komunës së Rahovecit dhe për ato çështje të cilat lidhen drejtpërdrejt me segmentet e qeverisjes e që sot janë në rend të ditës dhe për çështjen kryesore që është Projektligji për Hoçën e Madhe. Ne jemi shumë të angazhuar dhe tejet të vendosur që artikulojmë qartë shqetësimet, kërkesat, nevojat dhe kundërshtimet e qytetarëve të Komunës, Shoqërisë civile, Kuvendit të Komunës, kryetarit të Komunës dhe të gjitha asociacioneve që janë kundër Projektligjit. Ne kemi ftuar në takim të jashtëzakonshëm Komisionin parlamentar sot, ne do të shkojmë edhe hënën në qoftë se do të futet ky Projektligj në seancën dhe do të jemi aty dhe do të bëjmë ç'është e mundur që ky Projektligj i dëmton në kurriz qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe e cenon rëndë integritetin territorial të Komunës dhe të institucioneve. Pra, ky Projektligj i cili bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, LVL, Ligjin për zgjedhjet, Ligjin për trashëgiminë kulturore, ne do të punojmë dhe do të jemi të vendosur të shkojmë deri në fund.

**Labinot Berisha** – parimisht kërkoj prej jush si kryetar i Komunës këtë çështje ta shtroni edhe në nivel takimesh me qytetarë dhe t'i informoni për këtë Projektligj sepse jam shumë i bindur që qytetarët e Komunës së Rahovecit nuk janë të informuar dhe nuk janë në dijeni të plotë në esencë se çka përmban ky Ligj.

**Smajl Latifi** – dy vjet e gjysmë është punuar në këtë Projektligj dhe askush nuk ka ditur asgjë ndërsa tani për këtë Projektligj din edhe Brukseli dhe Vashingtoni.

**Nahit Elshani** – këtë pikë të rendit të ditës është mirë me lënë për një seancë tjetër sepse ne nuk mund të shqyrtojmë raportin pa prezencën e juaj, nuk mund të vazhdojmë mbledhjen pa prezencën e Kryesuesit sepse nuk kemi zëvendës kryesuesin i cili udhëheq mbledhjen.

**Rasim Fazliu** – sa i përket Projektligjit për Hoçën e Madhe kemi qenë unik dhe kemi dalë me deklaratë, mirëpo a të ndërpritet apo bojkotohet seanca, mendimi im personal nuk është ajo aq shumë e vlershme që të ndërpritet seanca në shenjë bojkoti sepse ne kemi shpreh mendimin tonë dhe jemi kundër atij Projektligji. Mirëpo, konsideroj që kjo seancë pasi që agjenda është ngjeshur të bëjmë një pauzë njëorëshe dhe pastaj të vazhdojmë seancën ose të caktohet për një ditë tjetër.

**Elhami Zhuniqi** – pajtohem me propozimin e Salihut që kjo mbledhje të bojkotohet në shenjë pakënaqësie për mospërfilljen e deklaratës të këshilltarëve të Kuvendit Komunal të Rahovecit kundër Projektligjit për Hoçën e Madhe sepse siç shihet Projektligji është në procedim e sipër kështu që bojkoti mbledhjes do të jetë edhe një mesazh për zyrtar qeveritar që ky Projektligj të ndërpritet dhe të mos procedohet më tutje.

**Fehmi Hoxha** – kemi një përgjegjësi shumë të madhe dhe u informuam na kryetari i cili tha se këtij Kuvendi di t'i drejtohen anëtarët e Grupit parlamentar të Kuvendit të Kosovës ndërsa ne dëshirojmë të bojkotojmë, këndë po e bojkotojmë. Propozoj që kjo mbledhje të shtyhet për një orë dhe kur të vjen ai komision të debatojmë. Ne duhet t'i qasemi problemit sepse me bojkotime nuk bëjmë asgjë.

**Salih Hoti** – ne kemi propozimin që seanca të bojkotohet por ne nuk bëjmë bisedë me ata pse është bojkotuar seanca, prandaj propozimi duhet të hidhet në votim.

**Kryesuesi** – kush është për vazhdimin e seancës me pauzë, mirëpo të vazhdohet pas pauzës. Me shumicë votash në shenjë të mos kënaqësisë së këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit për

shkak se Ligji për Hoçën e Madhe është proceduar në Parlamentin e Kosovës që ne si Kuvend i Komunës jemi të pakënaqur dhe e bojkotojmë seancën e sotme. Bëjmë thirrje që ky Projektligj të mos aprovohet në Parlamentin e Republikës së Kosovës.

**Smajl Latifi** – bojkoti i seancës ka të bëjë me heqjen e rendit të ditës aktual e meqë këtu janë të pranishëm anëtarët e Komisionit parlamentar ju propozoj që të debatoni çështjen për të cilën kanë ardhur ata.

**Nahit Elshani** – seanca e sotme që është thirrur me rendin e ditës të përcaktuar është e bojkotuar në shenjë të pakënaqësisë për draftimin e Projektligjit për Hoçën e Madhe, ndërsa tani propozoj që ne si Kuvend komunal të futemi në një seancën të jashtëzakonshme e cila ka për pikë të rendit të ditës debatimin për Projektligjin për Hoçën e Madhe.

**Feim Fetoshi** – ne si Kuvend komunal e miratuar më herët një deklaratë dhe nuk e di si do të procesoni që Kuvendi komunal ka miratuar një deklaratë dhe po të njëjtën mbledhje Kuvendi Komunal e ka bojkotuar mbledhjen, do të thotë jemi në kundërshtim të vetes tonë. Ju qoftë për nderë atyre që këqyrin me krijua poenë politike për këtë çështje, por megjithatë për shkak se është çështja serioze dhe për shkak të respektit ndaj deputetëve të nderuar që janë këtu mendoj se ne duhet të vazhdojmë dhe ne e trajtojmë këtë çështje si ndërrim të rendit të ditës dhe të vazhdojmë për çështjen aktuale.

**Esad Haxhijaha** – thirrjet për këtë mbledhje ne kemi marr para 10 dite, në ndërkohë qenka pa e nevojshme që Komunën tonë të vizitoj Grupi parlamentar nga Parlamenti i Kosovës. A nuk ka mundur që ky Grup parlamentar të njoftohet se ne kemi mbledhjen e KK-së në ora 10 dhe nëse është dashur të bëhet vizita ajo të bëhet më vonë apo një ose dy ditë më vonë ose të na njoftojë kryesuesi se mbledhja shtyhet për ditën tjetër. Rreth çështjes së Hoçës së Madhe ne në mbledhjen e kaluar kemi thënë mendimet tona të cilat i janë dërguar Grupit parlamentar dhe Parlamentit dhe tani ky draft Ligj po shqyrtohet edhe njëherë. Çfarë nevojë kemi që sot të bojkotojmë mbledhjen, nëse duhet të shohim rezultatet e këtij shqyrtimi për së dyti dhe ai rezultat është negativ, atëherë mund të bojkotohet dhe mund të bëhet një reagim tjetër. Nga kjo nuk është kjo mbledhje rezultat i bojkotimit për i asaj që nuk mund të mbajmë dy mbledhje në të njëjtën kohë, mbledhjen me grupin parlamentar dhe mbledhjen me këshilltarë të Kuvendit të Komunës.

**Smajl Latifi** – ju thashë që në fillim se sot kryetari i Komunës ka ftuar në takim të jashtëzakonshëm Komisionin parlamentar dhe nuk bëhet fjalë për poenë politike dhe të mos zhvendosemi nga tema qendrore për shkak të rrezikshmërisë të futjes të hënën të këtij Projektligji dhe nuk ka kohë, prandaj ne e kemi ftuar për ta shpalosur edhe një herë qëndrimin tonë zyrtar edhe si institucione komunale por edhe si shoqëri civile me fjalë tjera për ta ritheksuar pozicionin tonë, kundërshtimin tonë të thellë dhe unitetin që kemi ne kundër Projektligjit për Hoçën e Madhe. Ne jemi këtu për ti thënë Komisionit parlamentar edhe njëherë fuqimisht se jemi kundër Projektligjit. Dhe unë ju ftoj me radhë, kryesuesi të shpalos në emër të Asamblesë qëndrimin zyrtar, kryetari në emër të Qeverisë dhe në emër të qytetarëve pozicionin e vet para Komisionit parlamentar, shefat e grupeve parlamentare në emër të partive politike dhe shoqëria civile të thotë fjalën e vet.

**Kryesuesi** – propozoj që të japim një pauzë dhe të konsultohemi me kryetarët e grupeve të këshilltarëve dhe nëse dakordohemi të mbajmë seancën e jashtëzakonshme.

Përfunduar në ora 11,30.

K r y e s u e s i,  
Kujtim Popaj